



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 1, Datë 27.01.2015

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “IMPIANTIN E TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT TË ELBASANIT DHE PRODHIMIT TË ENERGISË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË ELBASAN**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Mjedisit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit dhe prodhimit të energjisë”, me vendndodhje në Bashkinë Elbasan dhe subjekt kërkues shoqërinë konçensionare “Albtek Energy” sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
  - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
  - b. Harta e Planvendosjes së Strukturës.
3. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT**



**Z. LEFTER KOKA**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Lefter Koka".

**MINISTËR I MJEDISIT**



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Adelina Greca".



**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**